

DIPLOTALKS

DIPLO TALKS

Janar 2026

Mirësevini në DIPLO-TALKS!

DIPLO-TALKS është buletini mujor që sjell në vëmendje zërin, vizionin dhe veprimin e diplomacisë shqiptare në arenën ndërkombëtare. Ai pasqyron arritjet kryesore të përfaqësive tona diplomatike dhe konsullore, si edhe zhvillimet më të rëndësishme të politikës së jashtme, në shërbim të interesave strategjike të Shqipërisë.

Në çdo edicion, DIPLO-TALKS përmbledh ngjarjet më domethënëse të muajit, aktivitetet kyçe të procesit të integritit evropian, diplomacinë ekonomike dhe kulturore, angazhimin me diasporën, si dhe iniciativa që forcojnë imazhin dhe rolin e Shqipërisë si një aktor i besueshëm dhe konstruktiv në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përmes shembujve konkretë suksesi, buletini synon të evidentojë punën e përditshme të diplomacisë sonë dhe ndikimin real të saj në promovimin e paqes, zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.



DIASPORA



SAMITI IV
DIASPORES



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORES

Albanian Diaspora Summit 2030
Through Roots We Rise

SAVE THE DATE
14-15 APRIL 2026
Tirana, Albania



Njoftim për t'u shpërndarë!

Diaspora rikthehet në shtëpi!

Bashkohuni në një hapësirë unike dialogu dhe bashkëpunimi, ku shqiptarët nga e gjithë bota lidhen me institucionet dhe komunitetet në Shqipëri. Ky samit ofron mundësinë për të ndarë ide, përvoja dhe projekte, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit tonë dhe në vizionin për Shqipërinë 2030. Mos e humbisni këtë mundësi për të qenë pjesë e ndryshimit dhe të ardhmes së përbashkët!

[Link për regjistrimin e pjesëmarrësve!](#)



Diaspora Shqiptare në veprim: Hapet thirrja për profesionistë

[Regjistri i Profesionistëve të Diasporës](#)

Më 17 janar 2026, është ofruar sërish mundësia për profesionistët shqiptarë të diasporës në Kanada që të regjistrohen në Regjistrin e Profesionistëve të Diasporës, në sektorët kyç si ekonomi, tregti, energjetikë, infrastrukturë, turizëm, teknologji, kibernetikë, inovacion dhe bujqësi. Kjo iniciativë krijon një rrjet të gjallë dhe aktiv të Këshilltarëve të Jashtëm, profesionistë vullnetarë që do të kontribuojnë në projekte me interes të ndërsjellë, duke sjellë njohuri, eksperiencë dhe ide inovative nga diaspora drejt Shqipërisë. Përmes platformës, pjesëmarrësit jo vetëm që përditësojnë të dhënat e tyre dhe ndajnë informacion me MEPJ dhe Ambasadat, por krijojnë mundësi reale për të ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe inovacionin e vendit, duke kthyer talentin dhe ekspertizën e tyre në një burim konkret për të ardhmen e Shqipërisë.

Një Komunitet Aktiv: Fuqia e Bashkëpunimit Shqiptar në Greqi

Për të katërtin vit radhazi, rubrika “Një Komunitet Aktiv” vazhdon të jetë një dritare e veçantë për të pasqyruar angazhimin dhe kontributin e shoqatave dhe organizatave joqeveritare shqiptare në Greqi. Publikuar një herë në muaj, kjo rubrikë evidenton aktivitetet kulturore, arsimore, sociale dhe humanitare që forcojnë lidhjet komunitare dhe promovojnë vullnetarizmin. Përmes saj, tregohen historitë e suksesshme të bashkëpunimit mes organizatave dhe roli i tyre vendimtar në ruajtjen e identitetit kombëtar, integrimin shoqëror dhe përmirësimin e jetës së përditshme të bashkatdhetarëve. “Një Komunitet Aktiv” synon të frymëzojë dhe të inkurajojë çdo anëtar të komunitetit që të kontribuojë në zhvillimin dhe mirëqenien e përbashkët.



Diaspora Shqiptare në Kroaci dhe Kontaktet me Vendin Amë

Biznesmeni shqiptar në Kroaci, z. Blerim Sela, CEO i Perpetuum Mobile d.o.o., shprehu interes për zgjerimin e biznesit të tij në Shqipëri, duke treguar rëndësinë e rolit të diasporës në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Takimi shërbeu gjithashtu për promovimin e Samitit të Diasporës më 14–15 prill 2026, një mundësi kyçe për të forcuar lidhjet mes diasporës dhe vendit amë.



NGJARJET KRYESORE



1. Spiropali: Shqipëria gati për të marrë përgjegjësitë e saj si [Anëtare Themeluese e Bordit të Pages](#)
2. Zelenski dekoron Spiropalin në Kiev me [Urdhrin e Lartë Shtetëror](#)
3. Erdogan takon Spiropalin: [Shqipëri–Turqi për Pagen Rajonale](#)
4. [Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit](#), Spiropali: Shpëtimi i hebrenjve, maja morale e historisë sonë

INTEGRIMI NË BE




Takim me Raporterin e Parlamentit Evropian, Andreas Schieder

Ministrja për Europën dhe Punët e Jashtme, Elisa Spiropali, priti në Tiranë Raporterin për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Andreas Schieder, të cilin e konsideron mbështetës të procesit të zgjerimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Ata ndanë vlerësime për ecurinë e negociatave dhe reformat në sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore. Diskutimi u fokusua te arritja e piketave ndërmjetme (IBAR), një hap kyç drejt mbylljes së kapitujve dhe përparimit të Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në BE në 2026.

Dialog për Integrimin në BE

Nën kujdesin e Ministres Spiropali dhe Ambasadorit të RSH në Vjenë Fate Velaj, MEPJ organizoi në Vlorë Forumin e Dialogut “...edhe disa hapa akoma drejt BE-së”, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama dhe Raporterit për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Andrew Schieder.

Forumi theksoi fazën vendimtare të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pas hapjes së gjashtë grup kapitujve, si dhe angazhimin politik dhe diplomatik për përparimin e procesit. Ministrja Spiropali prezantoi vizionin për vitin 2026 si vitin e “ofensivës diplomatike”, me fokus në avancimin e negociatave, forcimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimin e rolit të Shqipërisë si partner serioz i BE-së.



Workshop me European Movement Danimarkë

Më 27 janar, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Danimarkë organizoi një workshop në bashkëpunim me European Movement Danimarkë dhe gazetën Copenhagen Post, ku u prezantua progresi i Shqipërisë në procesin e integrimit evropian. Ky takim ofroi një hapësirë për diskutime të hapura mbi zhvillimet e fundit, sfidat dhe mundësitë që hapen për vendin në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Përmes këtij workshopi, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me strategjitë e reformave të Shqipërisë dhe të ndajnë ide dhe eksperiencë mbi përmirësimin e procesit të integrimit. Ky aktivitet forcon lidhjet ndërkombëtare dhe promovon Shqipërinë si një partner aktiv dhe i përkushtuar në proceset evropiane, duke krijuar ura bashkëpunimi midis profesionistëve, medias dhe institucioneve në Danimarkë dhe Shqipëri.

Vizion i përbashkët Shqipëri–Mali i Zi për zhvillim dhe integrim evropian

Në një intervistë për revistën Diplomacy&Commerce, Ambasadorja Peto diskutoi rëndësinë e marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, duke nxjerrë në pah stabilitetin rajonal dhe perspektivat evropiane. U theksua bashkëpunimi i ngushtë në fusha kyçe si infrastruktura, energjia dhe procesi i anëtarësimit në BE, duke u fokusuar në një vizion të përbashkët për zhvillim ekonomik dhe integrim strategjik të rajonit.





Shqipëria krah sigurisë kolektive: Ceremonia e Ndërrimit të Komandës në EUFOR ALTHEA

Më 21 janar 2026, u zhvillua Ceremonia e Ndërrimit të Komandës në bazën e EUFOR-it, Kampi Butmir, një moment i rëndësishëm që shënoi kalimin e drejtimit nga Gjeneral Major Florin-Marian Barbu i Forcave të Armatosura Rumune te Gjeneral Major Maurizio Fronda i Forcave të Armatosura Italiane. Prania e përfaqësimit shqiptar dhe angazhimi i vazhdueshëm i Kontigjentit të Forcave të Armatosura dëshmojnë përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë ndaj paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e ndërkombëtar. Pjesëmarrja në Misionin EUFOR ALTHEA pasqyron vlerat që na bashkojnë me partnerët tanë strategjikë: bashkëpunimin, përgjegjësinë e përbashkët dhe sigurinë kolektive.

DIPLOMACIA EKONOMIKE

Save the date: Korridori VIII në Momentin Strategjik të Europës: Lidhshmëri, Qëndrueshmëri dhe Mirëqenie e Përbashkët përmes Integritimit.

Me 18 shkurt 2026, në Tiranë, zhvillohet Forumi Ekonomik i Korridorit VIII, mënjëherë pas takimit Ministror. Forumi do të shërbejë si një platformë e rëndësishme dialogu dhe bashkëpunimi, duke mbledhur autoritete publike, institucione financiare ndërkombëtare dhe aktorë ky ekonomikë, për të adresuar dimensionet e ndërlidhshmërisë, investimeve dhe zhvillimit ekonomik rajonal përgjatë korridorit VIII. Në një moment vendimtar, të karakterizuar nga dinamika e përshpejtuar e zgjerimit të BE-së, përgatitja e Kuadrit Financiar Shumëvjeçar të BE-së dhe prioritetet e rritura për qëndrueshmërinë dhe lëvizshmërinë ushtarake brenda NATO-s dhe BE-së, Korridori VIII shfaqet si një bosht strategjik evropian. Duke u shtrirë në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Bullgari, me lidhje drejt Italisë dhe Rumanisë, ai përfaqëson një komponent kyç të Rrjetit Trans-Europian të Transportit (TEN-T), me rol thelbësor në forcimin e lidhshmërisë rajonale, sigurisë kolektive dhe qëndrueshmërisë strategjike. Një hap i rëndësishëm në institucionalizimin e këtij bashkëpunimi ishte Takimi i parë Ministror i mbajtur në Brindisi, Itali, më 27 korrik 2023, i cili theksoi rëndësinë strategjike të korridorit për transportin, tregtinë dhe gatishmërinë mbrojtëse, si dhe nevojën për koordinim politik më të fortë dhe përshpejtim të zbatimit të projekteve infrastrukturore.



Shqipëria në FITUR 2026: Destinacioni evropian i turizmit cilësor dhe të qëndrueshëm

Shqipëria u prezantua me sukses në panairin ndërkombëtar të turizmit FITUR 2026 në Madrid, një nga ngjarjet më të rëndësishme globale të industrisë, me pjesëmarrjen e mbi 160 vendeve dhe 10,000 kompanive nga e gjithë bota.

Me mbi 110,000 turistë spanjollë që vizituan Shqipërinë gjatë vitit 2025, interesi për vendin tonë është në rritje të vazhdueshme. Shqipëria po afirmohet gjithnjë e më shumë si një destinacion turistik gjithëvjetor, që ofron përvoja autentike duke ndërthurur natyrën, trashëgiminë kulturore dhe mikpritjen tradicionale.



EU for Food Safety – Albania”: Shqipëria Promovon Ushqimin dhe Bujqësinë në Berlin

Gjatë 14–17 janarit 2026, Shqipëria u prezantoi Potencialet e saj në Forumit Global të Ushqimit dhe Bujqësisë (GFFA) dhe Panairin Ndërkombëtar Green Week në Berlin. Ministri i Bujqësisë, Andis Salla, zhvilloi takime të nivelit të lartë duke u fokusuar ne projektet prioritare të vendit, përfshirë iniciativën “EU for Food Safety – Albania”.

Pjesëmarrja në këto ngjarje ndërkombëtare nxorri në pah inovacionin në sektorin bujqësor dhe produktet autentike shqiptare, duke theksuar rolin e Shqipërisë si një partner i besueshëm për sigurinë ushqimore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky angazhim hap rrugë për mundësi konkrete për eksport dhe investime, duke vendosur Shqipërinë në qendër të tregjeve ndërkombëtare dhe inovacionit bujqësor.

Shqipëria dhe Azerbajxhani: Partneritet kyç në Furnizimin me Gaz

Në një intervistë për TREND News më 16 janar 2026, Ambasadori Besart Kadia theksoi rëndësinë e sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm të Shqipërisë me gaz përmes TAP, duke e cilësuar si një hap kyç drejt sigurisë energjetike. U nënvizua potenciali për zgjerimin e bashkëpunimit në energji të pastër, transport, tregti, turizëm, bujqësi, arsim dhe shkëmbime kulturore, duke forcuar partneritetin strategjik mes dy vendeve dhe mundësitë për investime.



DIPLOMACIA KULTURORE



Shqipëria në TV5MONDE: Trashëgimi Kulturor dhe Diplomaci Ekonomike në Hapsirën Frankofone

Shqipëria merr vëmendjen e botës frankofone! Në Francë, TV5MONDE transmeton një episod të veçantë të Destination Francophonie, dedikuar plotësisht Shqipërisë. Dokumentari sjell në pah trashëgiminë e pasur kulturore, lidhjet e vendit me komunitetin frankofon dhe orientimin evropian, duke e pozicionuar Shqipërinë si destinacion kulturor dhe turistik tërheqës. Përveç promovimit të kulturës, programi thekson edhe roli në rritje i Shqipërisë në diplomacinë ekonomike, duke e bërë vendin një partner strategjik për bashkëpunime dhe investime në tregjet frankofone. Ky episod është një mundësi unike për të njohur Shqipërinë në sy të botës dhe për të festuar identitetin dhe potencialin e saj global.

[Intervista e plotë](#)



Ismail Kadare – Ambasadori i Përhershëm i Shqipërisë Europiane

Në 90-vjetorin e lindjes së Ismail Kadaresë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme organizoi një ekspozitë unike që përfshinte letërkëmbime, botime të rralla, artefakte dhe objekte autentike nga “Shtëpia Studio Kadare”. Ministria Elisa Spiropali theksoi rolin e Kadaresë si zë i ndërgjegjes kombëtare dhe europiane, ndërsa në ceremoni mori pjesë edhe Ministria e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, duke theksuar rëndësinë e trashëgimisë së tij për të gjithë komunitetin shqiptar.

Përtej Tiranës, Ambasada e Shqipërisë në Shkup zhvilloi dy aktivitete të veçanta kulturore dhe letrare, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe kulturore lokale. Në SHFK “Ismail Qemali”, nxënësit dhe mësime të gjuhës shqipe morën pjesë në një orë letrare interaktive, ndërsa Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturorë të Shqiptarëve organizoi një ngjarje shkencore-letrare kushtuar figurës dhe krijimtarisë së Kadaresë. Këto aktivitete theksojnë jo vetëm trashëgiminë e jashtëzakonshme të shkrimtarit, por edhe rolin e tij si ambasador i përhershëm i Shqipërisë në Europë dhe në botë.

Thellimi i Bashkëpunimit Kulturor Shqipëri–Bullgari në Fushën e Operas

Gjatë një takimi me Drejtorin e Operas së Soñes, z. Plamen Kartalof, u riafirmua interesi i ndërsjellë për forcimin e lidhjeve operistike ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë. Maestro Kartalof vlerësoi bashkëpunimin ekzistues dhe propozoi realizimin e një bashkë-produksioni me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të Shqipërisë, duke vënë në skenë një vepër të Richard Wagner në Tiranë, me orkestrën shqiptare dhe artistë nga të dy vendet, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt integritetit kulturor rajonal.





Kur fjala bëhet atdhe: promovimi i librit ‘Unë, Bija e Atdheut

Më 29 janar 2026, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Serbi, promovoi librin “Unë, Bija e Atdheut” të autores Amina Nurja. Një zë i ri, por i vendosur, Nurja, njëkohësisht Kryetare e Degës së Këshillit Kombëtar Shqiptar për Novi Pazarin në Serbi, i sjell lexuesit shqiptar një vepër reflektuese mbi atdheun, identitetin dhe kombin, të parë përmes syrit kritik dhe pasionit të një aktivisteje të re. Aktiviteti u përshëndet nga Drejtoresha e QKLL-së, Alda Bardhyli, Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, Enkel Rexhepi, Kryetari i Shoqatës “Tirana”, Shkëlqim Hajdari, si dhe Kryetari i Fondacionit “Rrënjët tona”, prof. Sazan Guri, duke e kthyer këtë promovim në një moment të veçantë dialogu kulturor dhe kombëtar.

Arti shqiptar në Bienalen e 10-të në Pekin

Shqipëria shënoi një moment të rëndësishëm në skenën ndërkombëtare të artit me pjesëmarrjen në Bienalen e 10-të Ndërkombëtare të Artit në Pekin, ku morën pjesë artistë nga 130 vende. Artistja shqiptare Ledia Çeta përfaqësoi vendin me punimin e saj të veçantë “Nën det”, duke tërhequr vëmendjen e vizitorëve dhe autoriteteve të pranishme, si dëshmi se arti shqiptar vazhdon të fitojë hapësirë dhe njohje në skenën globale. Ky moment nxorri në pah talentin dhe kreativitetin e artistëve tanë, duke lidhur Shqipërinë me kulturën botërore.



CITAT



“

"Shqipëria do i qëndrojë busullës së saj morale si Anëtare e Bordit të Paqes të Presidentit Trump."

Tiranë, Janar 2026

Ministër Elisa Spiropali